



# Kolegji AAB

## **KOLEGJI AAB FAKULTETI I INFERMIERISË**

### **RAPORTI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT PËR STAFIN ADMINISTRATIV NGA STUDENTËT**

Programi (BSc) Bachelor i Infermierisë & (MSc) Menaxhment Shëndetësor

**Zyra e Sigurimit të Cilësisë  
Janar, 2023**


Ky raport përmbledhës paraqet të dhënat e vlerësimit të studentëve të programit BSc Infermieri dhe MSc Menaxhment Shëndetësor për stafin administrativ, shërbimet administrative, infrastrukturën dhe kushtet e studimit në Fakultetin e Infermierisë të Kolegjit AAB.

Vlerësimi është realizuar pas përfundimit të semestrit dimëror, përkatësisht semestrit dimëror të vitit akademik 2022 – 2023 në të cilin janë përfshirë të gjithë studentët e programit BSc Infermieri dhe MSc Menaxhment Shëndetësor.

Pyetësi për vlerësimin e stafit administrativ dhe shërbimeve administrative përbëhet nga 11 pyetje dhe studentët janë përgjigjur sipas 5 nivele të ndryshme të pajtueshmërisë (shkallës së Likurit) nga “nuk pajtohem aspak” deri te “pajtohem plotësisht”. Përpos pyetjeve, studentët kanë dhënë mendimet e tyre përmes komenteve të hapura, në të cilat ata kanë rekomanduar përmirësimin e aspekte të ndryshme të funksionimit të administratës dhe kushteve fizike të studimit.


Në vazhdim, në formë grafike, janë paraqitur vlerësimet e përgjithshme të studentëve dhe rekomandimet përfundimtare për përmirësim.

**Figura 1.** Vlerësimi i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në lidhje me gatishmërinë e Dekanatit për t’iu përgjigjur kërkesave dhe ankesave të tyre në kampusin e Prishtinës




Në figurën më sipër, është paraqitur vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në lidhje me gatishmërinë e Dekanatit për t’iu përgjigjur kërkesave dhe ankesave të tyre në kampusin e Prishtinës. Rezultatet e paraqitura më lartë tregojnë se Dekanati i Fakultetit të Infermierisë mesatarisht iu përgjigjet kërkesave të studentëve. Këtë e pohojnë rreth 60.50% të studentëve, ndërsa 26.80% e studentëve janë deklaruar neutral dhe 5.21% prej tyre deklarohen se nuk pajtohen aspak.

**Figura 2.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në lidhje me njoftimin me kohë për procesin e mësimit dhe përgjigjet e kërkesave të tyre nga referentët në kampusin e Prishtinës




Në figurën më lartë është paraqitur vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në lidhje me njoftimin me kohë për procesin e mësimit dhe gatishmërinë e referentëve në kampusin e Prishtinës për t’iu përgjigjur kërkesave të studentëve. Rezultatet e paraqitura më sipër tregojnë se referentët i njoftojnë me kohë studentët për çdo informacion në lidhje me procesin e mësimit dhe iu përgjigjen kërkesave të tyre, pasi ky konstatim është pohuar nga rreth 75.8% të studentëve. 17.30% e studentëve janë shprehur neutral ndërsa vetëm 3.26% janë deklaruar se nuk pajtohen aspak.

**Figura 3.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga arkëtarët në kampusin e Prishtinës




Në lidhje me vlerësimin e shërbimeve të pagesave të kësteve mujore/vjetore, studentët e Fakultetit të Infermierisë janë shprehur të kënaqur me shërbimet e ofruara në kampusin e Prishtinës. Rezultatet e paraqitura më lart tregojnë se arkëtarët janë efikase në ofrimin e shërbimeve të tyre dhe këtë e pohojnë rreth 76.% të studentëve. 18.10% e studentëve janë deklaruar neutral ndërsa 3.05% pohojnë se nuk pajtohen aspak.

**Figura 4.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në lidhje me ofrimin e shërbimeve të fotokopjes në kampusin e Prishtinës




Në figurën më lartë është paraqitur vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në lidhje me ofrimin e shërbimeve të fotokopjes në kampusin e Prishtinës. Rezultatet e paraqitura më lart tregojnë se shërbimet e fotokopjes janë mesatarisht në nivel, pasi këtë e kanë deklaruar rreth 57.60% e studentëve. 24.90% e studentëve janë deklaruar neutral ndërsa 8.45% e studentëve janë shprehur që nuk pajtohen aspak që shërbimet e fotokopjes janë të nivelit të lartë.

**Figura 5.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në lidhje funksionimin e platformës elektronike e-Service në kampusin e Prishtinës




Sa i përket funksionimit të platformës elektronike e-Service, vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në kampusin e Prishtinës është se platforma është funksionale dhe përmban të gjitha shërbimet e nevojshme për ta. Këtë e pohojnë rreth 75% të studentëve të cilët janë pajtuar që platforma funksionon në mënyrë efektive dhe përmban të gjitha shërbimet dhe informacionet e nevojshme për student. 17.90% e studentëve janë deklaruar neutral ndërsa 3.03% nuk janë pajtuar aspak me deklarin e mësipërm.

**Figura 6.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në lidhje me sallat e ligjëratave, ushtrimeve dhe praktikave në kampusin e Prishtinës




Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në lidhje me sallat e ligjëratave, ushtrimeve dhe praktikave në kampusin e Prishtinës është i lartë. Rreth 71.4% e studentëve pajtohen që sallat e mësimiit janë të përshtatshme, ndërsa 19.50% e studentëve janë shprehur neutral dhe 4.10% nuk janë pajtuar aspak me deklarin e mësipërm.

**Figura 7.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakulteti të Infermierisë në lidhje me pajisjet për mbajtjen e ligjëratave dhe praktikave në kampusin e Prishtinës




Në figurën më lartë është paraqitur vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, në lidhje me pajisjet për mbajtjen e ligjëratave dhe praktikave në kampusin e Prishtinës. Rezultatet e paraqitura tregojnë se pajisjet për mbajtjen e ligjëratave dhe praktikave janë të përshtatshme pasi këtë e pohojnë rreth 66.49% të studentëve. Megjithatë 23.70% e studentëve janë shprehur neutral ndërsa 3.37% prej tyre nuk pajtohen aspak.

**Figura 8.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në lidhje me qasjen në internet dhe shërbimet tjera të teknologjisë në kampusin e Prishtinës




Rezultatet e paraqitura më sipër, tregojnë se në përgjithësi studentët e Fakultetit të Infermierisë janë të kënaqur me qasjen në internet dhe me shërbimet e tjera të teknologjisë informative. Rreth 63.90% e studentëve kanë pohuar se këto shërbime janë të nivelit të lartë, ndërsa 23.80% prej tyre janë shprehur neutral dhe 3.98% nuk pajtohen aspak me këtë deklaram.

**Figura 9.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, në lidhje me numrin e ofruar të librave fizik dhe elektronik në biblioteka, si dhe sallat e leximit në kampusin e Prishtinës




Në figurën më sipër, është paraqitur vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në lidhje me numrin e ofruar të librave fizik dhe elektronik në biblioteka, si dhe sallat e leximit në kampusin e Prishtinës. Rezultatet e paraqitura tregojnë se studentëve iu ofrohet një numër i mjaftueshëm i librave fizik dhe elektronik në biblioteka dhe se sallat e leximit janë të përshtatshme për lexim, pasi këtë e pohojnë rreth 64.2% të studentëve. 24.60% e studentëve janë deklaruar neutral ndërsa 3.83% nuk pajtohen aspak me një deklaram të tillë.

**Figura 10.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në lidhje me higjienën dhe mirëmbajtjen në kampusin e Prishtinës



Studentët e Fakultetit të Infermierisë vlerësojnë lartë higjienën dhe mirëmbajtjen e Fakultetit pasi këtë e pohojnë rreth 71,4.2% të studentëve. 19.90% e studentëve janë shprehur neutral ndërsa vetëm 3.71% nuk pajtohen aspak me deklaramin e mësipërm.


**Figura 11.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, në lidhje me higjienën dhe orarin e autobusëve në kampusin e Prishtinës



Në lidhje me higjienën dhe orarin e autobusëve në kampusin e Prishtinës, studentët e Fakultetit të Infermierisë në kampusin Prishtinë, janë shprehur të kënaqur, pasi këtë e pohojnë rreth 54,60% të studentëve. Megjithatë 26.50% e studentëve janë shprehur neutral ndërsa 8.20% e studentëve nuk pajtohen aspak që higjiena dhe orari i autobusëve janë në nivelin e duhur.




**Figura 12.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në lidhje me gatishmërinë e Dekanatit për t’iu përgjigjur kërkesave dhe ankesave të tyre në kampusin e Ferizajt




Në figurën më sipër, është paraqitur vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në lidhje me gatishmërinë e Dekanatit për t’iu përgjigjur kërkesave dhe ankesave të tyre në kampusin e Ferizajt. Rezultatet e paraqitura më lartë tregojnë se Dekanati i fakultetit të Infermierisë mesatarisht iu përgjigjet kërkesave të studentëve pasi këtë e pohojnë rreth 54.80% të studentëve. 36.20% e studentëve janë deklaruar neutral ndërsa 2.94% nuk pajtohen aspak me këtë deklaram.

**Figura 13.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Ferizaj, në lidhje me njoftimin me kohë për procesin e mësimit dhe përgjigjet e kërkesave të tyre nga referentët




Studentët në kampusin Ferizaj, janë shprehur të kënaqur me shërbimet e ofruara nga referentët e Fakultetit, në lidhje me procesin mësimor dhe zgjidhjen e kërkesave të tyre. Rreth 67.90% e studentëve janë pajtuar që referentët i njoftojnë me kohë për çdo informacion në lidhje me procesin mësimor dhe iu përgjigjen kërkesave të tyre. 19.80% e studentëve janë deklaruar neutral dhe 3.77% pohojnë se nuk pajtohen aspak.

**Figura 14.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë në lidhje, kampusi Ferizaj, me ofrimin e shërbimeve nga arkëtarët




Rezultatet e paraqitura më sipër tregojnë se arkëtarët janë efikase në ofrimin e shërbimeve të pagesave të kësteve mujore pasi këtë e pohojnë rreth 66.90% të studentëve. 26.40% e studentëve janë shprehur neutral dhe 1.88% pohojnë se nuk pajtohen aspak me një deklaram të tillë.

**Figura 15.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Ferizaj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve të fotokopjes




Shërbimet të fotokopjes në kampusin Ferizaj janë vlerësuar mesatarisht nga studentët. Rreth 42.43% e studentëve pajtohen se shërbimet e fotokopjes janë të nivelit të lartë, mirëpo 17.90% e studentëve janë shprehur neutral ndërsa 21.60% prej tyre janë shprehur se nuk pajtohen aspak.

**Figura 16.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Ferizaj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve të platformës elektronike e-Service




Studentët e Fakultetit të Infermierisë, kampusi Ferizaj, vlerësojnë se shërbimet e ofruara nga platforma elektronike e-Service është funksionale dhe se platforma përmban të gjitha shërbimet e nevojshme për ta. Këtë e pohojnë rreth 80.15% të studentëve.

**Figura 17.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Ferizaj, në lidhje me sallat e ligjëratave, ushtrimeve dhe praktikave




Me sallat e ligjëratave, ushtrimeve dhe praktikave, studentët e Fakultetit të Infermierisë në kampusin Ferizaj, janë mesatarisht të kënaqur. Rezultatet e paraqitura më sipër tregojnë se sallat e ligjëratave, ushtrimeve dhe praktikave janë mesatarisht të përshtatshme pasi këtë e pohojnë rreth 54.60% të studentëve. 18.80% e studentëve janë shprehur neutral ndërsa 15.09% prej tyre nuk pajtohen aspak.

**Figura 18.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Ferizaj, në lidhje me pajisjet për mbajtjen e ligjëratave, orëve praktike dhe formave të tjera të mësimdhënies




Studentët e Fakultetit të Infermierisë, kampusi Ferizaj, janë mesatarisht të kënaqur me pajisjet për mbajtjen e ligjëratave dhe praktikave. Rreth 51.83% e studentëve janë pajtuar që pajisjet janë të përshtatshme, ndërsa 22.60% e studentëve janë shprehur neutral dhe 11.30% nuk pajtohen aspak me një deklaram të tillë.

**Figura 19.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Ferizaj, në lidhje me qasjen në internet dhe shërbimet tjera të teknologjisë




Në figurën më lartë është paraqitur vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Ferizaj, me qasjen në internet dhe shërbimet tjera të teknologjisë informative. Studentët janë mesatarisht të kënaqur me internetin dhe shërbimet e TI-së pasi rreth 51.8% e studentëve janë pajtuar që këto shërbime janë të nivelit të lartë. 32.07% e studentëve janë shprehur neutral ndërsa 13.20% e studentëve janë deklaruar që nuk pajtohen aspak me një deklaram të tillë.

**Figura 20.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Ferizaj, në lidhje me numrin e ofruar të librave fizik dhe elektronik në biblioteka, si dhe për sallat e leximit




Studentët nuk janë shprehur shumë të kënaqur me numrin e librave fizik dhe elektronik të ofruar në bibliotekë, dhe me sallat e leximit. Vetëm 44.7% e studentëve janë pajtuar që numri i librave në bibliotekë dhe sallat e leximit janë të përshtatshme. 25.70% e studentëve janë shprehur neutral, ndërsa 29.4% e studentëve nuk pajtohen një deklaram të tillë.

**Figura 21.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Ferizaj, në lidhje me higjienën dhe mirëmbajtjen e kampusit




Studentët e Fakultetit të Infermierisë, kampusi Ferizaj, janë të kënaqur me higjienën dhe mirëmbajtjen e kampusit. Rreth 74,40% e studentëve janë pajtuar që higjiena dhe mirëmbajtja e kampusit është e nivelit të lartë, 16.90% e studentëve janë shprehur neutral ndërsa 4.71% prej tyre nuk pajtohen aspak.

**Figura 23.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Gjakovë, në lidhje me gatishmërinë e Dekanatis për t’iu përgjigjur kërkesave dhe ankesave të tyre




Studentët e Fakultetit të Infermierisë, kampusi Gjakovë, janë shprehur të kënaqur me shërbimet e pranuar nga dekanati. Sipas vlerësimeve, rreth 81% e studentëve janë pajtuar që dekanati i përgjigjet gjithmonë me kohë kërkesave dhe ankesave të tyre. 15.50% prej tyre janë shprehur neutral ndërsa vetëm 3.44% nuk janë pajtuar aspak me një deklaram të tillë.

**Figura 24.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Gjakovë, në lidhje me njoftimin me kohë për procesin e mësimit dhe zgjidhja e kërkesave të tyre




85.19% e studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Gjakovë, kanë vlerësuar se referenti i fakultetit njofton me kohë studentët për çdo informacion në lidhje me procesin e mësimit dhe i përgjigjen kërkesave të tyre. 8.19% e studentëve janë shprehur neutral ndërsa 3.27% nuk pajtohen aspak me një deklaram të tillë.

**Figura 25.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Gjakovë, në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga arkëtarët




Rezultatet e vlerësimit, tregojnë se arkëtarët janë efikase në dhënien e shërbimeve të pagesave të kësteve mujore në kampusin Gjakovë, dhe këtë e pohojnë rreth 88.10% e studentëve. 8.47% e studentëve janë shprehur neutral ndërsa vetëm 1.69% e studentëve nuk pajtohen aspak me një deklaram të tillë.

**Figura 26.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Gjakovë, në lidhje me ofrimin e shërbimeve të fotokopjes




Shërbimet të fotokopjes në kampusin Gjakovë janë vlerësuar mesatarisht nga studentët e Fakultetit të Infermierisë. Vetëm rreth 49.10% e studentëve pohojnë se shërbimet e fotokopjes janë të nivelit të lartë, 15.20% prej tyre janë shprehur neutral, 18.60 nuk pajtohen me një deklaram të tillë ndërsa 16.90% prej tyre nuk pajtohen aspak që shërbimet e fotokopjes janë të nivelit të lartë.

**Figura 27.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Gjakovë, në lidhje me ofrimin e shërbimeve të platformës elektronike e-Service



Studentët e Fakultetit të Infermierisë, kampusi Gjakovë, vlerësojnë lartë platformën E-Service. Rreth 89.76% e studentëve janë pajtuar që platforma elektronike funksionin në mënyrë efektive dhe përmban të gjitha shërbimet që iu nevojiten. 8.19% e studentëve janë shprehur neutral ndërsa asnjë i pakënaqur.


**Figura 28.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Gjakovë, në lidhje me sallat e ligjëratave, ushtrimeve dhe praktikave



Rezultatet e paraqitura më lartë tregojnë sallat e ligjëratave, ushtrimeve dhe praktikave në kampusin Gjakovë janë të përshtatshme. Rreth 65.56% e studentëve janë pajtuar që sallat janë të përshtatshme, 26.20% e studentëve janë shprehur neutral ndërsa 3.27% e studentëve nuk pajtohen aspak me një deklaram të tillë.




**Figura 29.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Gjakovë, në lidhje me pajisjet për mbajtjen e ligjëratave dhe praktikave




Sipas studentëve, pajisjet për mbajtjen e ligjëratave, praktikave dhe formave të tjera të mësimdhënies në kampusin Gjakovë janë të përshtatshme. Rreth 67.1% e studentëve janë pajtuar me një deklaram të tillë, megjithatë 26.20% e studentëve janë shprehur neutral, 8.19% e tyre nuk pajtohen me një deklaram të tillë ndërsa 3.27% janë deklaruar se nuk pajtohen aspak.

**Figura 30.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Gjakovë, në lidhje me qasjen në internet dhe shërbimet tjera të teknologjisë informative




Studentët e Fakultetit të Infermierisë, kampusi Gjakovë, kanë vlerësuar pozitivisht qasjen në internet dhe shërbimet e tjera të teknologjisë informative. Rreth 74.9% e studentëve janë pajtuar që qasja në internet dhe shërbimet e tjera të TI-së janë të nivelit të lartë, 21.60% e tyre janë shprehur neutral ndërsa rreth 3.3% e tyre nuk pajtohen aspak me një deklaram të tillë.

**Figura 31.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Gjakovë, në lidhje me numrin e ofruar të librave fizik dhe elektronik në biblioteka, si dhe sallat e leximit



Numri i librave fizik dhe elektronik si dhe sallat e leximit në kampusin Gjakovë janë vlerësuar mesatarisht. 59.3% e studentëve pohojnë se numri i librave është i mjaftueshëm dhe se sallat e leximit janë të përshtatshme, megjithatë 30.50% e studentëve janë shprehur neutral dhe rreth 10% e studentëve nuk janë pajtuar me një deklaram të tillë.

**Figura 32.** Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë, kampusi Gjakovë, në lidhje me higjienën dhe mirëmbajtjen



Studentët e Fakultetit të Infermierisë, kampusi Gjakovë, vlerësojnë lartë higjienën dhe mirëmbajtjen e kampusit. Këtë e pohojnë rreth 81,8% të studentëve, 14.70% e studentëve janë shprehur neutral dhe vetëm 3.27% e studentëve nuk pajtohen aspak me një deklaram të tillë.

## **PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME:**

Në bazë të rezultateve të mësipërme, Zyra e Sigurimit të Cilësisë konsideron se në përgjithësi vlerësimi i shërbimeve administrative dhe infrastrukturës është pozitiv. Megjithatë, duke qenë se Kolegji AAB synon ofrimin e shërbimeve të shkëlqyeshme administrative për studentët si dhe infrastrukturë të avancuar për procesin mësimor, ZSC konsideron se një rezultat i tillë maksimal në këtë semestër nuk është arritur. Sidomos, ZSC konsideron se përqindja në rritje e vlerësimit të studentëve me opSIONIN “neutral” duhet të hetohet tutje.

Në këtë drejtim, Zyra e Sigurimit të Cilësisë, i rekomandon menaxhmentit të AAB-së këto veprime:

- Dekanati i Fakultetit të jetë më i disponueshëm në përgjigjen e kërkesave dhe ankesave të studentëve (kampusi Prishtinë).
- Shërbimet e fotokopjeve të jenë më të qasshme ndaj përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të studentëve (Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë).
- Të ofrohet mundësia e qasjes më të lehtë në librat elektronik dhe fizik për studentë si dhe të zgjerohen hapësirat e leximit (Prishtinë, Ferizaj).
- Të përmirësohet higjiena në autobus si dhe të rishikohet orari i transportit konform kërkesave të studentëve (Prishtinë).
- Të sigurohet se pajisjet për mbajtjen e ligjëratave dhe ushtrimeve janë të përshtatshme për student (kampusi Gjakovë).
- Të sigurohet se qasja në internet dhe shërbimet e tjera të TI-së janë të nivelit të lartë (Ferizaj).
- Të sigurohet se sallat e ligjëratave dhe ushtrimeve të jenë të përshtatshme për student (Ferizaj).

## Shtojca 1

**Tabela 1. Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë për stafin administrativ dhe infrastrukturë në kampusin e Prishtinës**

Pyetja	Nuk Pajtohem Aspak	Nuk Pajtohem	Neutral	Pajtohem	Pajtohem plotësisht
Dekanati i Fakultetit i përgjigjet gjithmonë në kohë kërkesave/ankesave të drejtuara nga ana ime	5.21%	7.30%	26.8%	36.3%	24.2%
Referenti/ja i fakultetit na njofton me kohë për çdo informacion në lidhje me procesin e mësimit dhe i përgjigjet të gjitha kërkesave të mia	3.26%	3.43%	17.3%	36.9%	38.9%
Arkëtarët janë efikase në ofrimin e shërbimeve të pagesave të kësteve mujore/vjetore	3.05%	2.65%	18.1%	41.5%	34.5%
Shërbimet e fotokopjes janë në nivelin e lartë	8.45%	8.79%	24.9%	35.1%	22.5%
Platforma elektronike e-service funksionon në mënyrë efektive dhe përmban të gjitha shërbimet/informacionet që më nevojiten	3.03%	3.88%	17.9%	39.4%	35.6%
Sallat e ligjëratave/ ushtrimeve/praktikës dhe të formave të tjera të mësimdhënies janë të përshtatshme	4.10%	4.83%	19.5%	40.7%	30.7%
Pajisjet për mbajtjen e ligjëratave, orëve praktike dhe formave të tjera të mësimdhënies janë të përshtatshme	3.37%	6.35%	23.7%	39.4%	27.09%
Qasja në internet dhe shërbimet tjera të teknologjisë informative janë në nivel të lartë	3.98%	8.20%	23.8%	36.1%	27.8%
Numri i librave fizik dhe elektronik në biblioteka është i mjaftueshëm si dhe sallat e leximit janë të përshtatshme	3.83%	7.21%	24.6%	38.4%	25.8%
Higjiena dhe mirëmbajtja e kampusit është e nivelit të lartë	3.71%	4.89%	19.9%	32.7%	38.7%
Higjiena dhe orari i autobusëve janë në nivelin e duhur	8.20%	10.5%	26.5%	34.1%	20.5%

**Tabela 2. Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë për stafin administrativ dhe infrastrukturë në kampusin e Gjakovës**

Pyetja	Nuk Pajtohem Aspak	Nuk Pajtohem	Neutral	Pajtohem	Pajtohem Plotësisht
Dekanati i Fakultetit i përgjigjet gjithmonë në kohë kërkesave/ankesave të drejtuara nga ana ime	0%	3.44%	15.5%	37.9%	43.1%
Referenti/ja i fakultetit na njofton me kohë për çdo informacion në lidhje me procesin e mësimit dhe i përgjigjet të gjitha kërkesave të mia	3.27%	3.27%	8.19%	31.1%	54.09%
Arkëtarët janë efikase në ofrimin e shërbimeve të pagesave të kësteve mujore/vjetore	1.69%	1.69%	8.47%	32.2%	55.9%
Shërbimet e fotokopjes janë në nivelin e lartë	16.9%	18.6%	15.2%	23.7%	25.4%
Platforma elektronike e-service funksionon në mënyrë efektive dhe përmban të gjitha shërbimet/informacionet që më nevojiten	0%	0%	8.19%	36.06%	55.7%
Sallat e ligjëratave/ ushtrimeve/praktikës dhe të formave të tjera të mësimdhënies janë të përshtatshme	3.27%	4.91%	26.2%	29.5%	36.06%
Pajisjet për mbajtjen e ligjëratave, orëve praktike dhe formave të tjera të mësimdhënies janë të përshtatshme	3.27%	8.19%	21.3%	26.2%	40.9%
Qasja në internet dhe shërbimet tjera të teknologjisë informative janë në nivel të lartë	1.66%	1.66%	21.6%	38.3%	36.6%
Numri i librave fizik dhe elektronik në biblioteka është i mjaftueshëm si dhe sallat e leximit janë të përshtatshme	3.38%	6.77%	30.5%	30.5%	28.8%
Higjiena dhe mirëmbajtja e kampusit është e nivelit të lartë	0%	3.27%	14.7%	40.9%	40.9%
Higjiena dhe orari i autobusëve janë në nivelin e duhur	3.63%	3.63%	40%	21.8%	30.9%

**Tabela 3. Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Infermierisë për stafin administrativ dhe infrastrukturë në kampusin e Ferizajit**

Pyetja	Nuk Pajtohem Aspak	Nuk Pajtohem	Neutral	Pajtohem	Pajtohem Plotësisht
Dekanati i Fakultetit i përgjigjet gjithmonë në kohë kërkesave/ankesave të drejtuara nga ana ime	2.94%	5.88%	36.2%	34.3%	20.5%
Referenti/ja i fakultetit na njofton me kohë për çdo informacion në lidhje me procesin e mësimit dhe i përgjigjet të gjitha kërkesave të mia	3.77%	8.49%	19.8%	41.5%	26.4%
Arkëtarët janë efikase në ofrimin e shërbimeve të pagesave të kësteve mujore/vjetore	1.88%	4.71%	26.4%	41.5%	25.4%
Shërbimet e fotokopjes janë në nivelin e lartë	21.6%	17.9%	17.9%	26.4%	16.03%
Platforma elektronike e-service funksionon në mënyrë efektive dhe përmban të gjitha shërbimet/informacionet që më nevojiten	0.94%	3.77%	15.09%	49.05%	31.1%
Sallat e ligjëratave/ ushtrimeve/praktikës dhe të formave të tjera të mësimdhënies janë të përshtatshme	15.09%	11.3%	18.8%	31.1%	23.5%
Pajisjet për mbajtjen e ligjëratave, orëve praktike dhe formave të tjera të mësimdhënies janë të përshtatshme	11.3%	14.1%	22.6%	35.8%	16.03%
Qasja në internet dhe shërbimet tjera të teknologjisë informative janë në nivel të lartë	8.49%	7.54%	32.07%	38.6%	13.2%
Numri i librave fizik dhe elektronik në biblioteka është i mjaftueshëm si dhe sallat e leximit janë të përshtatshme	17.1%	12.3%	25.7%	33.3%	11.4%
Higjiena dhe mirëmbajtja e kampusit është e nivelit të lartë	4.71%	3.77%	16.9%	44.3%	30.1%
Higjiena dhe orari i autobusëve janë në nivelin e duhur	7.92%	11.8%	46.5%	24.7%	8.91%